



Kemi vendosur në mënyrë kronologjike masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovë dhe ministrive për parandalimin e infeksionit Corona Virus COVID - 19.

Vendimi Nr. 01/07, i datuar 11/03/2020

Qeveria e Kosovës me anë të Vendimi Nr.01/07 në mënyrë që të parandaloj infeksionin Corona Virus COVID-19 ka urdhëruar implementimin e masave në vijim:

- Ndërprerja e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet deri më 27 mars 2020, me rekomandim që të lirohet njëri prind nga puna (kjo masë nuk vlen për punëtorët shëndetësor dhe për punëtorët e sektorit të sigurisë).
- Pezullimi i përkohshëm i linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor nga vendet me risk të lartë dhe të mesëm (deri në vendim tjetër);
- Kontrolli i obliguar i udhëtarëve nga ekipet mjekësore të Qendrës Kryesore Familjare në Kosovë, në të gjitha hyrje-daljet e Kosovës me mbështetjen e Policisë së Kosovës, të të gjithë qytetarëve që vijnë nga zonat epidemike, për detektimin e rasteve me COVID-19 dhe ndërmarrjen e masave parandaluese.
- Vetëkarantinimi i detyruar për të gjithë qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës nga zonat epidemike me rrezik të lartë dhe të mesëm, në përputhje me udhëzimet e OBSH-së (moszbatimi i dënueshëm sipas Ligjit për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse). Në rast se personat e caktuar nuk mund të vetëkarantinohen rekomandohen të vendosen në karantina të përbashkëta të caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Aktivitetet publike dhe jo publike mund të zhvillohen të mbyllura pa praninë e publikut si ngjarje/tubime sportive, tubime, koncerte, konferenca, tryeza të rrumbullakëta deri në vendim tjetër.
- Të ndalohet veprimtaria e restoranteve, klubeve të natës, palestrave, pishinave pas orës 23:00.
- Të ndalohet eksporti i pajisjeve, materialeve dhe medikamenteve mjekësore nga ana e operatorëve ekonomik dhe prodhuesve, përveç me Vendim të Qeverisë;
- Të gjitha Institucionet qeveritare si dhe ndërmarrjet publike dhe private detyrohen të ndërmarrin masa për mbrojtjen dhe dezinfektimin në të gjitha institucionet sipas udhëzimeve nga Ministria e Shëndetësisë, të cilat kanë të bëjnë me masat e përforcuara higjienike;



- Të gjitha ndërmarrjet publike dhe kompanitë privat që kryejnë transport publik të udhëtarëve, obligohen të bëjnë dezinfektim të rregullt të mjeteve transportuese;
- Do të ndalohet transporti i organizuar ndërkombëtar (autobus, minibus dhe të ngjashme), drejt vendeve me rrezik të lartë dhe anasjelltas;
- Personat fizik dhe juridik të cilët nuk i respektojnë dhe i shkelin rekomandimet do të ndëshkohen në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Vendimi Nr. 01/08 "Për Krijimin e Komisionit të Posaçëm për Parandalimin e Infeksionit të Corona Virus COVID - 19, i datës 12/03/2020 ("Vendimi Nr.01/08").

Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr.01/08, ka krijuar Komisionin e Posaçëm (tani e tutje "Komisioni") për Parandalimin e Corona Virus COVID-19, i cili është i përberë nga 20 anëtar dhe i kryesuar nga Kryeministri i Kosovës. Komisioni ka mandat të menaxhoj procesin e parandalimit të infeksionit të Corona Virus COVID - 19 dhe në emër të Qeverisë së Kosovës të kontrolloj implementimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e konsumatorëve me anë të organeve administrative shtetërore.

Ndër të tjera, ky vendim imponon masat në vazhdim:

- Të gjitha bizneset përfshirë, por pa u kufizuar, në farmaci dhe bizneset tjera që ofrojnë produkte ushqimore dhe higjienike obligohen të operojnë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe të mos abuzojnë me çmime të produkteve medicinale dhe ushqimore;
- Të gjitha institucionet janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë Komisionin për kryerjen e detyrave të tij;
- Komisioni do të mbikëqyrë punën e të gjitha institucioneve relevante që janë në kompetencë të Qeverisë dhe të koordinohet me institucionet tjera kushtetuese sipas rastit.
- Komisioni ndër të tjera, siguron:
 - a. Materiale të domosdoshme të shpërndahen nëpër qendrat mjekësore në të gjitha komunat, te policia, doganierët, policët kufitar dhe të gjitha shërbimet tjera emergjente;
 - b. Përgatitjen e objekteve të nevojshme në rast nevojë për vendosjen e personave të prekur;



- c.** Hyrjet dhe Daljet e qytetarëve nga Kosova do të kontrollohen nga personeli shëndetësor;
- d.** Bizneset do të kryejnë punën e tyre me nder e përgjegjësi, të mos lëvizin çmimet dhe institucionet përkatëse të kryejnë kontrollet në terren (markete, farmaci, në pika tjera ku ofrohen materialet bazike) bazuar në kompetencat ligjore që kanë në situata të tilla;
- e.** Të ketë komunikim me mediat publike dhe private, duke kontribuar në informim të drejtë e të plotë të qytetarëve për masat që duhet ndërmarr, po duke mos shkaktuar panik;
- f.** Qytetarëve tu ofrohen njoftimet dhe udhëzimet nga ana e institucioneve përgjegjëse, që të veprojnë sipas tyre;
- g.** Të kryej edhe detyra të tjerat të cilat kërkohen varësisht nga rrethana;
- Komisioni po ashtu është i obliguar t'ia propozojë Qeverisë për miratim masat parandaluese sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me këtë vendim.
- Në pajtim me nevojat dhe në mënyrë që të mund t'i përmbush obligimet e parapara, Kryesuesi i Komisionit mund të ftoj eksperte dhe përfaqësues të tjerë vendor dhe ndërkombëtar.
- Obligohen të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces për ofrimin e të dhënave dhe zbatimin e masave të kërkuara;
- Sekretariati Koordinues i Qeverisë do i ofroj Komisionit mbështetje Administrative;

Vendimi Nr. 01/09 "Për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID", i datës 13/03/2020 ("Vendimi Nr. 01/09").

Qeveria me anë të Vendimit Nr.01/09 ka imponuar masat në vazhdim:

- Ndalohen hyrje-daljet e qytetarëve në Komunën e Klinës;
- Ndalohen hyrje-daljet e qytetarëve në Komunën e Vitisë;
- Ndërpritet me efekt të menjëhershëm transporti ndër-urban në Republikën e Kosovës, si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar;



- Mbyllen kufijtë tokësor për udhëtarët që hyjnë në Kosovë, kjo nuk vlen për qytetarët kosovar, të gjithë shtetasit e Kosovës të cilët hyjnë përmes këtyre kufijve do t'u nënshtrohen kontrolleve të shtuara mjekësore me urdhrin që ata të vet izoloohen për 14 ditë;
- Nga data 16 mars 2020 ora 24:00, bëhet pezullimi i përkohshëm i të gjitha linjave të udhëtimit ajror në aeroportin e Prishtinës përveç fluturimeve ushtarake, dhe emergjencave medicinale (MEDIV AC). Përjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me ekuipazh por pa udhëtarë që shërbejnë vetëm për largim të udhëtareve nga Kosova;
- Mbyllen kafiteritë, baret, pabet dhe restorantet, qendrat tregtare me përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore;
- Pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive;
- Mbyllen tregjet e kafshëve dhe tregjet e automjeteve;
- Reduktohen në veprimet esenciale dhe staf esencial për çdo institucion publik përveç stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë;
- Urdhërohen kompanitë private që ta organizojnë punën në atë mënyrë që shumicën e aktiviteteve punëtorët t'i kryejnë nga shtëpia;
- U rekomandohet të gjithë qytetarëve që t'u shmangen ambienteve të frekuentuara me njerëz dhe t'u përmbahen të gjitha masave të ndërmarra nga Qeveria dhe rekomandimet e dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

Vendimi Nr.1/10 "Për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID - 19 në vazhdimësi të vendimit të Qeverisë Nr. 01/09", i datës 14/03/2020 ("Vendimi Nr. 01/10)

Qeveria e Kosovës duke aprovuar Vendimin Nr. 01/10 ka ndaluar hyrjet dhe daljet të qytetarëve në Komunën e Malishevës. Në bazë të këtij vendimi Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera do të sigurojnë ndërmarrjen e masave të nevojshme;



Vendimi Nr. 01/11 "Për Shpalljen e Emergjencës për shëndetin publik", I datës 15/03/2020 ("Vendimi Nr.1/11)

Qeveria e Kosovës pas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë ka shpallur emergjencë për shëndetin publik.

Me anë të këtij Vendimi, obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të veprojnë konform Planit të Reagimit Kombëtar dhe aktivizimi i funksionit mbështetës emergjent 8, i njohur si FME8.

Duke u bazuar në dispozitën 3 të Vendimit Nr. 1/11, Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencës për shëndetin publik.

Suspendimi i faturimeve dhe pagesave të taksës së pronës së paluajtshme

Duke u bazuar në Ligjin mbi tatimin në Pronën e Paluajtshme, Ministri i Financave dhe Transfereve ka marr Vendim për zgjatjen e afatit të lëshimit të faturave për tatimin mbi Pronën e Paluajtshme. Përkatësisht pagesës së këstit të parë për vitin 2020.

Masat e ndërmarra nga Banka Qëndrore e Kosovës

Banka Qëndrore e Kosovës ka marr vendim që:

- Bizneset dhe individët të cilët për shkak të gjendjes së krijuar në vend dhe rënies së nivelit të të hyrave të tyre, të ju mundësohet pezullimi i pagesave të kësteve të kredisë, nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020 dhe varësisht nga situata, ky pezullim mund të shqyrtohet edhe për më gjatë. Pezullimet e pagesave të kësteve të kredisë do të shqyrtohen për të gjitha rastet veç e veç me qëllimin që sektori bankar t'i ndihmoj klientëve të tyre në tejkalimin e situatës së krijuar;
- me rastin e pezullimit të pagesave të kredive, BQK-ja ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore që kreditë të mos klasifikohen, të mos kërkohen provizione shtesë dhe të mos klasifikohen si kredi me probleme në Regjistrin e Kredive.



Në mënyrë që këto masa të aplikohen për një kredimarrës specifik, atëherë ai kredimarrës duhet të:

- Ketë hasur në vështirësi financiare, si rezultat i rënies së të hyrave personale apo biznese, pastaj të kontaktohet banka e kredimarrësit/es me kërkesën për pezullim të pagesave të kësteve të kredisë. Në rastet e aprovimit nga ana e bankës, interesat ndëshkuese të lidhura me kreditë nuk do të aplikohen në këtë periudhë.

Ky dokument behet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe / ose angazhim te cdo lloj natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:

tax_legal-alko@deloittece.com